



Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafin 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nën paragrafin 2.6 dhe 2.16, Nenet 25 dhe 43 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë nr. 03/L-185;
- Rregulla për vendosjen e çmimeve të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe të Tregut (Rregulla për Çmimet të OST/OT);
- Vendimi nr. V_518_2013 për Të Hyrat Maksimale Të Lejuara (MAR) që do të mbulohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Tregut SHA (KOSTT);
- Aplikacionin e KOSTT-it të dorëzuar me datën 28 janar 2015, në kuadër të Shqyrtimit të Nëntë të Tarifave të Energjisë Elektrike(SHTE9) me dokumentacionin relevant sqarues.

Pas shqyrtimit të shkresave dhe dokumenteve relevante, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, **në seancën e mbajtur më 03 prill 2015 nxori këtë:**

VENDIM

- I. **APROVOHEN TË HYRAT MAKSIMALE TË LEJUARA (MAR)** që do të mbulohen nga **Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Tregut SHA (KOSTT)** përmes tarifave dhe ngarkesave për vitin relevant tarifor SHTE9.

ARSYETIM

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ka pranuar nga KOSTT-i aplikacionin për aprovim të Hyrave të Lejuara Maksimale që duhet mbledhur nga OST/OM përmes tarifave dhe ngarkesave të rregulluara.

Në marrjen e vendimit të tij për MAR që do të mbulohet nga OST/OM, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet si në vijim që janë lëshuar dhe publikuar në ueb faqen e saj:


- Vlerësimi përfundimtar, Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe të Tregut të Kosovës (KOSTT sh.a.), i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
- Vlerësimi përfundimtar- Pasqyrë, i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
- Raport Konsultativ - Kalkulimi i Kostos së Shitjes me Shumicë të Energjisë Elektrike, i publikuar më datën 09 Mars 2015;





- Raport Konsultativ - Kalkulimi i MAR-it të KOSTT-it , i publikuar më datën 09 Mars 2015;
 - Përgjigjet ndaj Komenteve - Shqyrtimi i nëntë i tarifave të energjisë elektrike SHTE9, i publikuar me datën 03 prill 2015.
- II. Të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga OST/OM për vitn relevant rregullativ janë **25,764,270** euro.
- III. Të Hyrat e Lejuara Maksimale për OST/OM do t'i nënshtrohen Procesit të Përshtatjeve të Rregullta vjetore, sipas Rregullës për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të transmisionit dhe tregut.
- IV. Të Licencuarit për OST/OM duhet t'i përgatisin dhe dorëzojnë për aprovim ZRRE-së ngarkesat për shfrytëzim të sistemit të transmisionit, të përcaktuar me këtë Vendim, brenda një afatit sa më të shkurtë.
- V. Ngarkesat e propozuara nga OST/OT duhet të jenë në përputhje me Metodologjinë e Ngarkesave për Shfrytëzimin e Rrjetit të Sistemit të Transmisionit (TNUOS), Metodologjinë e Ngarkesave të Operatorit të Sistemit dhe Metodologjinë e Ngarkesave të Operatorit të Tregut të aprovuara nga ZRRE .
- VI. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe atë angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në mes të përkthimeve, do të mbisundojë versioni i gjuhës shqipe.
- VII. Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të zbatohet nga KOSTT-i duke filluar nga 1 prilli 2015 deri në shqyrtimin e rregullt tarifor dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimi të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.

Bordi i ZRRE:


Enver Halimi, Kryesues


Merita Kostari, Anëtare


Krenar Bujupi, Anëtar